

Nr: 03-202/4
Shkup: 18.11.2020

Në bazë të nenit 28 paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18) dhe nenit 5 paragrafi (1) të Ligjit për kontrollin e ndihmës shtetërore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 145/10), Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në seancën e mbajtur më 18.11.2020, solli

MENDIM

Propozim - Programi për ndryshimin dhe plotësimin e Programit për Konkurrueshmëri, Inovacione dhe Ndërmarrësi për vitin 2020, i cili parashikon rritje të mjeteve financiare me futjen e një nën mase të re për mbështetje të zejtarëve për të përballuar më lehtë pasojat e Covid 19, dhe e cila nën masë vlen për zonën A të Programit (Mbështetje dhe zhvillim i ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme dhe zejtarisë) me titull: **Kofinancim të shpenzimeve për zejtarët për blerje të veglave dhe materialeve rinovuese në vlerë të përgjithshme prej 20.000.000 denarë**, ndërsa objekt i nën masës është kofinancimi i një pjese të shpenzimeve të zejtarëve për blerje të veglave dhe ripromaterialeve përmes kofinancimit deri në 60% të shpenzimeve faktike, por jo më shumë se 60.000 denarë individualisht për secilin aplikues, **paraqet ndihmë me vlerë të vogël (de minimis)** në kuptim të nenit 4 paragrafi (1) të Rregullores për kushtet dhe procedurën për dhënien e ndihmës me vlerë të vogël (de minimis) (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 141/11) dhe e njëjta **nuk paraqet ndihmë shtetërore** sipas nenit 9 paragrafi (1) të Ligjit për kontroll të ndihmës shtetërore. Dhënia e ndihmës me vlerë të vogël (de minimis) duhet të kryhet në përputhje me Rregulloren për kushtet dhe procedurën e dhënies së ndihmës me vlerë të vogël (de minimis).

Me vendimin e miratuar të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës në lidhje me Propozim-Programin për Konkurrueshmëri, Inovacione dhe Ndërmarrësi për vitin 2020 (për zonën A. Mbështetja dhe zhvillimi i ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme dhe zejtarisë) nr. 10-12 të datës 22.01.2020, buxheti i përgjithshëm për realizimin e zonën A ishte 34.740.000 denarë. Pas vendimit miratuar të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, programi bazë për zonën A është ndryshuar ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut", nr. 153/20), me ç'rast shuma e përgjithshme e mjeteve nga 34.740.000 denarë u zvogëluar në 22.040.000 denarë, kurse disa masa të caktuara nga Programi bazë janë shfuqizuar plotësisht. Me ndryshimet dhe plotësimet e propozuara aktuale të Programit për Konkurrueshmëri, Inovacione dhe Ndërmarrësi për vitin 2020, të cilat janë dorëzuar nga Ministria e Ekonomisë dhe janë objekt vlerësimi nga Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, futet një nën masë e re, por shuma e mjeteve financiare është rritur për 20.000.000 denarë për shkak të nevojës për zbatimin e nën masës së paraparë.

Në Programin bazë, shuma e përgjithshme e mjeteve për realizimin e fushës A të këtij Programi ishte 34.740.000 denarë, dhe e njëjta me ndryshimet e përmendura u zvogëluar në 22.040.000 denarë, kështu që me ndryshimet dhe plotësimet aktuale në Program rritet për 20.000.000 denarë, ndërsa shuma e përgjithshme e mjeteve financiare për realizimin e fushës A të këtij programi është 42.040.000 denarë Megjithatë, për shkak se nën masa e re për

kofinancimin e kostove për zejtarët për blerjen e veglave dhe repromaterialeve paraqet ndihmë de minimis (sepse çdo aplikant individualisht do të merrte deri në 60% të kostove, por jo më shumë se 60,000 denarë), Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës vlerësoi se nën masa e propozuar sipas përshkrimit të dhënë, i plotëson kushtet e parashikuara në nenin 4 paragrafi (1) pika 4 të Ligjit për kontroll të ndihmës shtetërore, gjegjësisht nenin 4 të Rregullores për kushtet dhe procedurën për dhënien e ndihmës me vlerë të vogël (de minimis), sepse ndihma totale për këtë qëllim që do t'i jepet një ndërmarrje të caktuar (zejtarëve) nuk e kalon shumën prej 200.000 euro për një periudhë trevjeçare fiskale.

Në shkresën e dërguar nga Ministria e Ekonomisë, ndër të tjera thuhet se propozimi për ndryshimin dhe plotësimin e Programit është bërë në pajtim me rregulloren me fuqi ligjore për ndryshimin dhe plotësimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2020, gjatë kohës së gjendjes së jashtëzakonshme (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 126/20) dhe shuma e përgjithshme e mjeteve prej 20.000.000 denarë është dedikuar për realizimin e nën masës së re 3.4. Kofinancimi i kostove për zejtarët për blerjen e veglave dhe ripromaterialeve. Me këtë Rregullore, 20.000.000 denarë të siguruara nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2020, Programi P1 Covid, janë të destinuara për ti mbështetur zejtarët për t'u përballur më lehtë me pasojat e Covid 19, dhe Ministria e Ekonomisë është përgjegjëse për realizimin e të njëjtave.

Gjatë zbatimit të këtyre masave nga fusha A e Programit të Konkurrueshmërisë, Inovacioneve dhe Ndërmarrësisë për vitin 2020, Ministria e Ekonomisë duhet të kujdeset që i njëjti përfitues i ndihmës shtetërore për të njëjtin qëllim/masë të mos marrë ndihmë shtetërore nga dy burime të ndryshme gjegjësisht, përveç masave të parapara në zonën A të Programit, të mos shfrytëzohen mjetet nga masat e ngjashme nga pakoja e krijuar e masave ekonomike kundër krizës të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për mbështetjen e ekonomisë në kushtet e "Covid-19".

Gjithashtu, Ministria e Ekonomisë gjatë zbatimit të këtyre masave duhet të veprojë në përputhje me nenin 7 (kumulimi) dhe nenin 8 (regjistrimi i ndihmës) të Rregullores për kushtet dhe procedurën e dhënies së ndihmës me vlerë të vogël (de minimis).

KRYETAR

I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Prof. Dr. Владимир Наумовски